



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:231226

Datë: 17.11.2022

Numri i dokumentit: 03654988

CP.nr.1000/22

GJYKATA THEMELORE – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, gjyqtarja Mirvete Alidema me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Abdyli, në lëndën përbarimore të kreditorit M.S nga Gj..., të cilin e përfaqëson avokat Ardit Latifi nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me shpërblimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore – në tekstin e mëtejme LPP-në, jashtë seancës më datën 17 Nëntor 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Urdhërohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Thesari në Prishtinë që mjetet monetare nga xhiro-llogaria e debitorit **Komuna e Gjilanit në emër të shpërblimit jubilar, kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe përbarimore, të bartet shuma prej 1,822.50 € (njëmijë e tetëqindë e njëzetë e dy eur e pesëdhjetë cent)**, në emër të përfaqësuesit të kreditorit **av.Ardit Latifi nga Gjilani, në xhirrollogarinë me nr.... në Bankën E...**, pasi që aktvendimi mbi caktimin e përbarimit **CP.1000/2022** i datës 08.11.2022, është bërë i ekzekutueshëm më datën 17.11.2022, në kuptim të nenit 152 të LPP-së.

II. Aktvendimi në dispozitivin **I** e ka efektin e aktvendimit për përbarim me të cilin është caktuar sekuestrimi i kredisë në të holla të debitores dhe kalimin e saj për arkëtim në dobi të kreditorit në kuptim të nenit 152 të LPP-re.

III. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

IV. Aktvendimi t'i dorëzohet palëve ndërgjyqësore, si dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave – Thesarit në Prishtinë kurse një ekzemplarë të ruhet për dosje.

A r s y e t i m i

Kreditori më datën 02.11.2022, ka ushtruar propozim për përbarim kundër debitorit Komuna e Gjilanit lidhur me shpërblimin jubilar dhe kompenzimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan **C.nr.577/20** të datës 02.03.2021, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit **Ac.nr.2298/21** të datës 22.09.2022, së bashku me

shpenzimet e procedurës në shumë totale prej **1,822.50 € (njëmijë e tetëqindë e njëzetë e dy eurp e pesëdhjetë cent)**.

Pasi që aktvendimi mbi caktimin e përmbartimit lëndor është i formës së prerë, në kuptim të nenit 152 LPP-së si dhe nenit 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive nr. 03/L – 48 janë plotësuar kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e trajtuar aktvendimin në dispozitivin **I**, si aktvendim me të cilin është caktuar sekuestrimi i kredisë në shumën monetare lëndore të debitorës në fjalë dhe kalimin e saj për arkëtim në dobi të kreditorit në fjalë si dhe nenit 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L -48.

Sa i përket shpenzimeve gjyqësore Gjykata llogariti shpenzimet e procedurës në shkallë të parë shumën prej **270€**, shumën prej **156 €** në emër të përpilimit të përmbartim, si dhe shumën prej **30 euro** për taksë gjyqësore për përpilimin e propozimit për përmbartim pasi që debitorja nuk i ka paguar në afatin e paraparë kreditorit dhe këto shpenzime janë krijuar pa vullnetin e këtij të fundit.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, sepse në kuptim të dispozitës së nenit 12 parag. 2 të LPP-re me dispozitat e nenit 144-156 nuk është paraparë paraqitja e ankesës kundër aktvendimit me të cilin urdhërohet banka ose ndonjë institucion tjetër përkatës siç kemi të bëjmë me rastin konkret në dispozitat e nenit 152 të LPP-re përkitazi me përmbartimin për kredinë sipas llogarisë në bankë. Arkëtimi lëndor i kredisë në të holla nga ana e subjekteve të caktuara siç kemi të bëjmë me rastin konkret është rregulluar me nenin 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive nr. 03/L – 48.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,
CP.nr.1000/2022, më datën 17 Nëntor 2022**

**Gjyqtarja.
Mirvete Alidema**

KËSHILLË JURIDIKE - Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.